

VENDIM
Nr. 379, datë 28.12.2023

MBI DISA NDRYSHIME TË PËRKOHSHME NË PROCEDURAT PËR DHËNIEN E GARANCIVE TË ORIGINËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RINOVUESHME

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22, pika 1 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neni 113 i ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative (KPA); nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2330/3 prot., datë 26.12.2023, të përgatitur nga grupi i punës;

konstatoi se:

- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE në kuptim të neneve 2 dhe 22, pika 14, duhet që t’i bashkohet sistemit rajonal me qëllim që të bëhet tregtimi i garancive të origjinës me palët e tjera kontraktuese të komunitetit të energjisë,

- Në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 22, pika 14, të ligjit nr. 24/2023, ERE ka nënshkruar marrëveshjen me konsulentin e përzgjedhur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në zbatim të përcaktimeve të pikës 2 të vendimit të Bordit nr. 140, datë 14.4.2023, “Për nënshkrimin e marrëveshjes së shërbimit me shoqërinë ‘Grexel System’ Ltd, si ofertues i shërbimit i përzgjedhur nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, për regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancisë së origjinës”.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 317, datë 8.11.2023, janë vendosur disa ndryshime të përkohshme në procedurat për dhënie të garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, të cilat do të jenë në fuqi për një periudhë tranzitore, deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të rregullores së re për lëshimin e GO-ve, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

- Gjatë implementimit të sistemit rajonal të regjistrit elektronik të GO-ve dhe hedhjes së të dhënave përkatëse, është konstatuar nevoja që të bëhet dhe një ndryshim për sa i përket afatit për të cilin lëshohen GO përkatëse, i cili duhet të jetë për një periudhë 1-mujore, ndaj vlerësohet që të bëhen disa ndryshime të përkohshme në nenin 7.2 dhe nenin 14.1 të “Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Në “Rregullores për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, bëhen ndryshimet në pikat 7.2 dhe 14.1, si më poshtë vijon:

7.2 “Garancia e Origjinës për një impiant prodhues të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme lëshohet me bazë mujore ose vjetore sipas kërkesës së aplikuesit”.

14.1 “Garancia e origjinës lëshohet për një periudhë 1-mujore ose 1-vjeçare dhe shteron fuqinë e saj sipas afatit të shprehur në certifikatën e garancisë së origjinës”.

2. Grupi i punës të bëjë ndryshimet përkatëse në rregulloren e sipërcituar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi